Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr. 327/20
Datë/Datum: 01.06.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Sahit Beqiri - Ekspert Shqyrtues	*Data e autorizimit të ekspertit:* **28.05.2020**	*Data e dorëzimit të raportit:* **01.06.2020**	Nr. i lëndës: **327/20**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: **21.05.2020**. OE: **N.SH.H. "Zona Park" - Prizren,** ka parashtruar ankesë me nr.: **327/20**, kundër **B58 njoftimit mbi vendimin e AK - (anulimin e aktivitetit te prokurimit)**, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Mirmbajtja e objekteve të Komunës së Prizrenit" – Lot. 2**, me nr. të prokurimit: **622-19-9525-2-1-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK): **Komuna e Prizrenit.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar: **Procedura e hapur**, lloji i kontratës: **Shërbime**, vlera e parashikuar e kontratës: **1,130,000.00 €**

Shënim: Ju njoftojë se lidhur me këtë aktivitet të prokurimit është nxjerr një (1) vendim nga OSHP.
Vendimi me Nr. 167/19, me datë: 07.04.2020

Konform.nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE NGA OE: N.SH.H. "Zona Park"- Prizren

(Të përshkruhen dispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

Neni 7 i LPP-së (Barazia ne Trajtim / Jo-Diskriminim),
Neni 28 i LPP-së (Specifikimet teknike),
Neni 59 i LPP-së (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve),
Neni 60 i LPP-së (Kriteret për dhënie te Kontratës),
Neni 108/A i LPP-së (Zgjedhja preliminare e mosmarrëveshjeve).

Ligjet shtesë:

Ligji i Punës Nr. 03/L-212 dhe
Neni 18 i RRUOPP-së

Vendimi i OSHP-së Nr. 167/20 e datës 07.04.2020

Kjo është procedure e Rivlerësimit si rezultat i vendimit te OSHP-se nr. 167/20 e datës 07.04.2020, ku ankesa jone është aprovuar si e bazuar.
Autoriteti kontraktues me date 08.05.2020 nxjerr vendimin për aprovimin pjesërisht te kërkesës për rishqyrtim te datës 07.05.2020 dhe lenden përsëri kthen ne Rivlerësim për herë te dytë.

Gjate ri-vlerësimit te ofertës sonë AK me date 08.05.2020 kërkon sqarimin nga kompania jone lidhur me një (1) kontrate te Universitetit te Prizrenit, ne ju jemi përgjigjur me date 11.05.2020 brenda afatit te lejuar kohore, duke dhënë sqarime rreth kontratës për te cilën kane kërkuar, ku i kemi bashkangjitur edhe dëshmi te mjaftueshme.

*****Pjesa 1*****

Ne vendimin e autoritetit kontraktues te datës 08.05.2020 ka kthyer përgjigje lidhur me pretendimin tone se raporti i ri-vlerësimit ka qene i nënshkruar vetëm nga ZPP (Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit) z. Isa Osmankaj dhe jo nga komisioni, i njëjti arsyetohet se për shkaqe te problemeve teknike nuk është ngarkuar pjesa ku janë te nënshkruar komisioni (çuditërisht)!.

Dokumenti i nënshkruar nga komisioni është futur si një ikonë ne vendimin e autoritetit kontraktues mirëpo e njëjta nuk është dorëzuar ne formatin "word" për tu hapur por ne formatin "pdf" e cila pamundëson hapjen e atij dokumenti, sigurisht është bere qëllimisht qe te mos hapet ky dokument.

Raport i përpiluar ka qene ne kundërshtim me Legjislacionin Sekondar te LPP-se dhe formave standarde te hartuara nga KRPP si manualisht si elektronike nga sistemi i E-prokurimit, forma standarde e emërtuar si forma B36.

Raporti i Ri-vlerësimit i datës 05.05.2020 nuk përmbante elemente saktësisht ku ceken se cilët kane qene afetaret e komisionit te rivlerësimit dhe nuk ka askënd nga 25/25 faqet e dorëzuara se ka komision te ri-vlerësimit dhe nënshkrimet e tyre nuk gjenden askënd, pra plotësisht ne kundërshtim edhe me dispozitat e nenit 40 te Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te LPP-së.

ZPP (Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit) ka vepruar ne kundërshtim me dispozitën 40.4 te Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te LPP-së, pasi qe i vetmi ai është qe ka nënshkruar pa komisionin e vlerësimit, ekziston dyshimi se faqja ku komisioni është nënshkruar me vone, pra është nxjerr pas paraqitjes se ankese sonë pasi qe dokumenti i nxjerrur ka plote 25 faqe nga 25 faqe totale dhe nuk mund te dalin tani 26 faqe.

Prove: Raporti i ri-vlerësimit i dorëzuar nga autoriteti kontraktues 25faqe.

***** Pjesa II *****

Sipas njoftimit mbi vendimin e AK-se te datës 13.05.2020 te publikuar ne platformën elektronike, autoriteti kontraktues **e anulon ne tersi** aktivitetin e prokurimit "Lot 2" pasi qe pretendon se pas rivlerësimit te ofertave nuk ka ofertues te përgjegjshëm.

Operatori ekonomik i cili ka qene i rekomanduar "SFK" Sh.p.k. për kontrate thuhet ne letrën standarde te eliminimit se pas kërkese se komisionit pika II te njoftimit te KRPP-se te dt. 30.05.2020 te sillet vërtetimi i ATK-se nga ky operator ekonomik, i njëjti tregon se **e ka sjella këtë vërtetim mirëpo figuron se ka borxhe** andaj edhe komisioni e ka shpall te papërgjegjshëm.

I njëjti nga autoriteti kontraktues duhet te drejtohet me kërkese për futje ne listën e zeze konfirm Nenit 99.2 të LPP-së pasi qe ka rene ne kundërshtim me Nenin 65 te LPP-se dhe deklarate nen betim, sepse i njëjti është deklaruar qe: **"pranon mundësin e sanksioneve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse për shkak te pakujdesisë dorëzon çfarëdo dokumenti ose deklarate qe përmbana informata përmbajtësish te gabueshme ose mashtruese".**

Po ashtu tek formulari i dorëzimit te tenderëve pika nr.1 dhe nr. 2 dhe nr. 7 thuhet:
Titulli i kontratës: Sigurimi fizik dhe mirëmbajtje e objekteve te Komunës se Prizrenit

Si përgjigje ndaj letrës suaj te ftesës për te tenderuar për kontratën e mësipërme, ne te poshtë nënshkruarit, deklarojmë qe:

1. i kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes se tenderit. Ne pranojmë dispozitat e saj ne tersi, pa rezervim ose kufizim.
2. Ne ofrojmë te dorëzojmë, ne pajtim me kushtet e dosjes se tenderit dhe afatet kohore te paraqitura pa rezerve apo kufizim:
7. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurrim, mund të kenë si rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të financuara nga BKK

S.B

Andaj, nëse ju si autoriteti kontraktues veproni ne kundërshtim me këto dispozite te LPP-së dhe nëse nuk ndërmerrni masat e duhura konform nenit 99.2 për këtë operator ekonomik, ju pajtoheni se keni qene ne bashkëpunim dhe jo ne dijeni se i njëjti ka ofruar dokumente mashtruese dhe deklarata mashtruese me përmbajtje persisht te rreme, i njëjti është deklaruar nen betim se është " **i përshtatshëm dhe ne përputhje me nenin 65 te LPP-se**" po ashtu i njëjti është deklaruar " **se vërteton dhe i ka lexuar kërkesat e përshtatshmërisë ne Nenin 65 te LPP-se, respektivisht paragrafi 6 te Informacionit te tenderuesit dhe vërteton se i përmbush kërkesat e përshtatshmërisë për pjesëmarrje ne këtë procedure te prokurimit**" , mirëpo teni del se i njëjti figuron ne ATK se është borxhliu dhe nuk mund te nxjerr vërtetimin e kërkuar tek "kërkesat e përshtatshmërisë", i njëjti me qe ka pasur dijeni se është borxhlinj ka ofertuar përsëri ne këtë aktivitet te prokurimit.

Ju rikujtojmë se është një vendim i OSHP-se lidhur me këtë operator ekonomik ku ka prova se i njëjti ka ofruar dokumentacion manipulues për dy biznese te ndryshme me emërtim te ngjashëm.

Provë: Deklarata nën betim e OE "SFK" Sh.p.k.

***** Pjesa III *****

Autoriteti kontraktues ne lidhje me procesin e ri-vlerësimit, përsëri ne eliminon nga procedura e këtij aktiviteti te prokurimit me te njëjtat arsyetime se nuk përmbushim kapacitetin teknik dhe profesional pjesa e kontratave te realizuara nuk kap vlerën prej 500,000.00€.

Autoriteti kontraktues pas aprovimit te pjesërisht te kërkese për rishqyrtim te datës 07.05.2020 ku ia kemi rikujtuar vendimin e OSHP-se, konform Panelit Shqyrtues ka kërkuar sqarime ne baze te Nenit 72 te LPP-se (vetëm për një kontrate me Universitetin e Prizrenit) nga kompania jone, kompania jone ka ofruar dy (2) lloj listash te kontratave e qe konform dosjes se tenderit **e plotëson kërkesën e autoriteti kontraktues.**

Ne sqarimin qe e kemi ofruar ne e kemi njoftuar autoritetin kontraktues se kemi kontrata, referenca dhe raporte për përfundimin e punëve te kryera ne vlera te mjaftueshëm dhe mbi 500,000.00€, kurse te njëjtët na eliminojnë me arsyetim se komisioni pas kalkulimit te të gjitha kontratave e referencave thuhet se kap vlerën prej 487,213.23 € andaj edhe oferta jone cilësohet se është e papërgjegjshme.

Autoriteti kontraktues nga listat e dorëzuara nuk ka marr parasysh kontrata te cilat vet i potencon se duhet te merren ne shqyrtim nga fundi i vitit 2016 deri ne fund te vitit 2019.

Kontrata te cilat kane ne periudhat e lartcekura <u>qe nuk jane marr per vlerësim:</u>

1. Komuna e Gjakovës e nënshkruar me date 20.10.2016 e cila ka hy ne fuqi me date 01.11.2016 dhe ka zgjatur deri me 31.10.2017 e cila kap vlerën prej 73,963.00€ e qe me këtë vlere kur i shtohet asaj prej 487,213.23€ tejkalohet vlera prej 500,000.00 € te kërkuar ne dosjen e tenderit.
   Këtë kontrate e gjeni ne dokumentin e dorëzuar ne platformën e-prokurimit me rastin e ofertimit tonë me titull: Kërkesat mbi mundeshit teknike dhe ose profesionale – ZZP.pdf nga faqe nr. 7 deri ne faqe nr. 11

Prove: Kontrata me Komune e Gjakovës e datës 20.10.2016 me titull: Mirëmbajtja – Pastrimi i objekteve te KPSH-se dhe QPS-se me nr. prokurimi: 632-16-030-221.

2. Komuna e Rahovecit e nënshkruar me date 18.12.2017 ne kohëzgjatje prej 12 muajve e cila kap vlerën prej 88,640.64 € dhe jo ashtu siç e keni cekur ju 88,000.00€/
   Këtë kontrate e gjeni ne dokumentin e dorëzuar ne platformën e-prokurimit me rastin e ofertimit tone me titull: Kërkesat mbi mundeshit teknike dhe ose profesionale – ZZP.pdf nga faqe nr. 35 deri ne faqe nr. 37

Prove: Kontrata me Komune e Rahovecit e datës 18.12.2017 me titull: Pastrimi dhe mirëmbajtja higjienike te objekteve te Komunës se Rahovecit me nr. prokurimi: 623-17-5187-2-2-1.

Po ashtu nuk i keni marre parasysh edhe kontrata tjerat e cilat kane qene te natyrës se njëjte, ju keni mundur te kërkoni edhe dëshmi tjera sipas Nenit 72 te LPP-se edhe për kontrata tjera e jo vetëm për një (1) për Universitetin e Prizrenit.

S.B

Sa i përket eliminimit te OE "MSS" Sh.p.k., autoriteti kontraktues ka vepruar konform vendimit te OSHP-se me nr. 167/20, pasi qe e njëjta nuk ka respektuar kërkesën e autoritetit kontraktues lidhur me llogaritjen e pushimit vjetor.

Autoriteti kontraktues nuk ka respektuar kriterin sipas nenit 60 te LPP-se, te rekomandoni ofertën e përgjegjshme me çmimin me te ulet, sepse kompania jonë është e përgjegjshme dhe është eliminuar me qellim nga autoriteti kontraktues, e kjo mund te vije për shkak se kompania jone ka dorëzuar Kallëzim penal ndaj ZPP dhe komisionit te rivlerësimit dhe kjo konsiderohet hakmarrje ndaj nesh qe po na bëjnë përsëri padrejtësi.

***** Pjesa IV *****

Autoriteti kontraktues ka vepruar ne kundërshtim me rregullat dhe dispozitat ligjore te LPP-se dhe nuk ka vepruar konform Nenit 108/A duke mos na u përgjigjur ne tërësi pretendimeve tona ankimore, por thjesht e nxjerr një vendi jo meritor, duke refuzuar kërkesën tone për rishqyrtim duke mos u marr fare me pretendimet tona ankimore.

Duke u mbështetur ne këto argumente dhe dispozite ligjore te lartpërmendura kërkojmë qe ankesa jone te **APROVOHET** si e **BAZUAR** dhe lënda te kthehet ne **Rivlerësim.**

Pretendimet ankimore (dispozitat e shkelura nga AK) – Ankesa në OSHP, janë të njëjta me Kërkesa për Rishqyrtim në AK. Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet në - Ankesën në OSHP -janë të njëjta me Kërkesa për Rishqyrtim në AK.

KRITERET PËR VLERËSIM

(Të vendosen vetëm kërkesa/kriteret që kanë të bëjnë me arsyet e eliminimit dhe/apo ato kërkesa që lidhen me pretendimet ankimore).

III.2.3) Kërkesat minimale te kualifikimit

Përshtatshmëria profesionale: : ***Dëshmia e kërkuar dokumentare***

Kërkesat:	Evidencat:
Kërkesa 1.Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo Regjistrin e ndërmarjeve në vendin e juaj të themelimit Kërkesa 2.Regjistrimi i Numrit Fiskal Kërkesa 3 OE duhet të jetë i regjistruar në TVSH ose të jetë deklarues i TVSH së Kërkesa 4 Licenca për shërbimet themelore të sigurimit dhe autorizimi, konform Ligjit 04/L-004 (valide), për loto 1	Evidenca 1 Certifikata e regjistrimit të biznesit me informatat për biznesin (kopje). Evidenca 2 Certifikata e numrit fiskal Evidenca 3 Qertefikata e TVSH së Evidenca 4 Kopja e Licencës dhe Autorizimi për nisjen fillestare të veprimtarisë (valide) e noterizuar, (për loto 1)

III.2.2) Kërkesat minimale te kualifikimit

Kapaciteti ekonomik dhe financiar: ***Dëshmia e kërkuar dokumentare***

Kërkesat:	Evidencat:
1. Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi i OE gjat tri viteve të shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) ka qen prej jo më pak se Për loto 1= 800.000,00 € Për loto 2= 500.000,00 €	Evidenca 1 Pasqyrat e qarkullimit financiare të kompanisë, të shoqëruar me qarkullimi financiar nga banka për tri vitet e shkuara apo deklaratat e tatimeve vjetore të dorzuara në Administratën Tatimore të Kosovës.

III.2.2) Kërkesat minimale te kualifikimit

Kapaciteti teknik dhe professional: ***Dëshmia e kërkuar dokumentare***

Kërkesat:	Evidencat:
Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së njëjtë gjatë 3 (tri) viteve të fundit (duke filluar nga data e publikimit të këtij njoftimi për kontratë) jo më pak se. Për loto 2= 500.000,00 euro Kërkesa 7 loto 2 OE duhet të prezentojë listën e stafit me të cilin planifikon të mbulojë kërkesat e dala nga kjo dosje e tenderit dhe nga paramasat. Kërkesa 8. Deklarate me shkrim nga OE qe I njejti do tu permbahet SPECIFIKIMEve TEKNIKE TË DETYRUESHME ANEKs I	Dëshmia 1 Lista e projekteve te natyrës së kontratës e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skenuar nga origjinali) për dosien elektronike, , të deshmuara me referenca dhe kontrata të cilat dëshmojnë vlerën e shërbimeve dhe natyrën e tyre apo proces verbal të pranimit përfundimtar të shërbimeve. Dëshmija 7 Lista e të punësuarve , përshkrimi i shkurtër I vendit të punës për stafin e rregullt kontratat e punës, për stafin e ri kontratat e bashkëpunimit për këtë projekt. Evidenca 8 Mungon ne NJ dhe DT, por kuptohet Deklrate me shkrim nga OE lidhur me Aneksin I te FDT-se

S.B

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar ne raportin e vleresimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si ne vijim: (Te përshkruhet vetëm vlerësimi i ofertës së OE ankues/ofertave, për te cilat OE ankues ka pretendime ankimore).

Zona Park i mungojnë: Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së njëjte gjatë 3 (tri) viteve të fundit (duke filluar nga data e publikimit të këtij njoftimi për kontratë) jo më pak se. Për loto 2= 500.000,00 euro 4. Ne procesin e rivlerësimit te ofertave, komisioni përkatës përmes zyrës se prokurimit ka kërkuar informata shtese nga OE ZONA PARK lidhur me kontratën e UPZ te arritur me date 15.04.2015 dhe ANEKS kontratën e datës 24.04.2018.

Pas marrjes se informatave shtese nga ky OE, komision ika vlerësuar te gjitha referencat e ofruara nga ky OE te cilat janë te natyrës se kontratës dhe te cilat shërbime janë realizuar nga data 13.12.2016 deri me date 13.12.2019.

- Nga ky vlerësim del si vijon kontrata e Komunës se Rahovecit vlera 88,000.00
- Kontrata e Komunës se Rahovecit e datës 10.07.2019 37,396.00
- Kontrata e Komunës se Ferizajt e datës 26.12.2018 vlera për 11 muaj 114,436.63
- Kontrata me UPZ e nënshkruar me date 15.04.2015 për 16 muaj 109,984.00
- Aneks kontrata e UPZ e datës 24.04.2018 vlera 137,396.60
- Totali i llogaritur i referencave te natyrës se kontratës te realizuara nga data 13.12.2016 deri me date 13.12.2019 është 487,213.23
- Nuk janë marr parasysh referencat e lëshuara para datës 13.12.2016 si pas datës 13.12.2019
- Nuk janë marr parasysh referencat te cilat nuk janë te natyrës se kontratës.
- Ne DT dhe NJK te publikuar nga AK thuhet se vlera e përgjithshme e referencave te natyrës se kontratës për periudhën tri vjeçare nga data e publikimit te njoftimit për kontrate duhet te jete jo me pak se 500,000.00 euro.
- Ky OE nuk e ka plotësuar këtë shume te referencave te natyrës se kontratës andaj shpallet i papërgjegjshëm.

Dëshmia 1 Lista e projekteve te natyrës së kontratës e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skanuar nga origjinali) për dosjen elektronike, , të dëshmuara me referenca dhe kontrata të cilat dëshmojnë vlerën e shërbimeve dhe natyrën e tyre apo proces verbal të pranimit përfundimtar të shërbimeve.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA ANA EEKSPERTËVE SHQYRTUES

////

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet nje vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).

///

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

(Të sqarohet nëse për rastin e njëjtë është dhënë vlerësim tjetër).

///

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Te sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).

///

S.B

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES: N.SH.H "Zona Park" - Prizren

- Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Përgjigje në Pretendimi Nr. 1

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se Autoriteti kontraktues ne lidhje me procesin e ri-vlerësimit, përsëri ne eliminon nga procedura e këtij aktiviteti te prokurimit me te njëjtat arsyetime se nuk përmbushim kapacitetin teknik dhe profesional pjesa e kontratave te realizuara nuk kap vlerën prej 500,000.00€. **Po ashtu nuk i keni marre parasysh edhe kontrata tjerat e cilat kane qene te natyrës se njëjte, ju keni mundur te kërkoni edhe dëshmi tjera sipas Nenit 72 të LPP-se edhe për kontrata tjera e jo vetëm për një (1) për Universitetin e Prizrenit.**

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive te dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet te prokurimit, OE ankues ne platformën elektronike e-prokurimi ka dorëzuar 2 (dy) lista te kontratave te nënshkruar dhe te vulosura njëra ne vlere: 711.039.88 €, kurse tjetra ne vlere: 1,847,259.99 €, duke bashkangjitur: kontrata, referenca, raporte te pranimeve etj.., Komisioni i vlerësimit ne raportin e datës 19.05.2020 tek deklarate vlerëson se OE ankues ka kontrata dhe referenca ne vlere **487,213.23 €**, mirëpo komisioni i vlerësimit nuk ka kërkuar sqarime (duke respektuar pjesërisht Vendimin e OHSP-se nr. 167/20 te datës 07.04.2020) dhe nuk ka vlerësuar kontratën e prezantuar ne listën e kontratave nga OE ankues te lidhur me Komunën e Gjakovës e cila hynë ne fuqi nga data 20.10.2016 deri 31.10.2017, me titull: Mirëmbajtja –Pastrimi i objekteve te KPSH-se dhe QPS-së me nr. prokurimi: 632-16-030-221, e cila ne nenin 3 te kësaj kontrate, vlera e parashikuar për shpenzime te kësaj kontrate kornize është: **73,963.00 €**, andaj, bazuar ne këto dëshmi dhe duke pas parasysh Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale **nenin 9.1 & 9.2 te FDT-se**, *Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së njëjte gjatë 3 (tri) viteve të fundit (duke filluar nga data e publikimit të këtij njoftimi për kontratë) jo më pak se Për loto 2= 500,000.00 €. Dëshmia 1 Lista e projekteve te natyrës së kontratës e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skenuar nga origjinali) për dosien elektronike, , të dëshmuara me referenca dhe kontrata të cilat dëshmojnë vlerën e shërbimeve dhe natyrën e tyre apo proces verbal të pranimit përfundimtar të shërbimeve*, OE ankues arrin te plotësoj këtë kërkesë te dosjes se tenderit, andaj konsideroj se AK - komisioni i ri-vlerësimit nuk ka vlerësuar, ekzaminuar dhe krahasuar drejt ofertat e operatoreve ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, me fjale tjera **nuk e ka respektuar nenin 7 paragrafi 2 të LPP-së**, po citoj: "*Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt te aktivitetit te prokurimit ne një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën ne mes te operatorëve ekonomik ose që diskriminon ne dëm ose ne te mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik*" si dhe **neni 59 par. 4 të LPP-së**, po citoj: "*Autoriteti kontraktues do te konsiderojë një tender si te përgjegjshëm vetëm nëse tenderi ne fjalë është ne përputhshmëri me te gjitha kërkesat e parashtruara ne njoftimin e kontratës dhe ne dosjen e tenderit*", si dhe **nenin 60 par.1 pika 1.1 te LPP-së**, po citoj: "*Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ose: 1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më te ulët*".

Gjithashtu, **Eksperti shqyrtues sqaron**, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive te dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, OE ankues ka prezantuar edhe disa kontrata shërbime te DDD (Dezinfektim, Dezinsektim, Deratizim) te cilat konsideroj se hynë ne lëmin (natyrës se njëjtë) te pastrimit dhe mirëmbajtjes, gjate tri viteve te fundit (duke filluar nga data e publikimit te këtij njoftimi për kontratë), ashtu siç është kërkuar ne njoftim për kontratë dhe dosje te tenderit.

Eksperti shqyrtues sqaron, lidhur me këtë pretendim mendon se AK – komisioni i vlerësimit, nëse ka pasur dyshime ka mundur të kërkoj sqarime shtesë bazuar në **nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së**, si dhe bazuar ne nenin 39 te RrUOPP-së. Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme

S.B

vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **është i qëndrueshëm.**

Përgjigje në Pretendimi nr.2

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, autoriteti kontraktues duhet te drejtohet me kërkese për futje ne listën e zeze, konfirm Nenit 99.2 të LPP-së për OE "SFK" Sh.p.k. i cili ka qene i rekomanduar nga AK, pasi qe ka renë ne kundërshtim me Nenin 65 te LPP-së dhe deklarate nen betim, sepse i njëjti është deklaruar qe: **"pranon mundësin e sanksioneve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse për shkak te pakujdesisë dorëzon çfarëdo dokumenti ose deklarate qe përmbana informata përmbajtësish te gabueshme ose mashtruese"**, pasi i njëjti tregon se **e ka sjella këtë vërtetim mirëpo figuron se ka borxhe** andaj edhe komisioni e ka shpall te papërgjegjshëm.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive te dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet te prokurimit, konsideron se **është ne diskrecionin dhe përgjegjësin e autoriteti kontraktues**, te beje një kërkesë me shkrim në lidhje me paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik. Pasi qe OSHP është e obliguar dhe ka autoritetin që të shqyrtojë, vetëm pas pranimit te një kërkesë me shkrim nga autoriteti kontraktues. Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **nuk është i qëndrueshëm.**

Përgjigje në Pretendimi nr.3

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se autoriteti kontraktues ka shkelur **nenin 28 dhe 108/A të LPP-së.**

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive te dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet te prokurimit, operatori ekonomik ankues i ka ngritur si pretendime tek dispozitat ligjore, kurse tek deklarata detale e fakteve dhe argumenteve nuk ka sqaruar se si dhe ne cilin/cilat rast/e autoriteti kontraktues ka shkelur këto nene të LPP-së, duke mos precizuar se pse nuk janë respektuar këto nene. Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë, **nuk është i qëndrueshëm.**

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues, ***të aprovohet si e bazuar***, dhe rekomandon të anulohet B58- Njoftimi mbi vendimin e AK (njoftimit për dhënie të kontratës) dhe lënda të kthehet në **Ri-vlerësim.**

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- *Autoritetit Kontraktues – Komuna e Prizrenit*
- *Panelit Shqyrtues – OSHP*
- *OE ankues – N.SH.H. "Zona Park" - Prizren,*

S.B